



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Administratës

1. Cfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës dhe përthithjen e ekspertëve në kuadër të rritjes së kapaciteteve.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose dhe korporata private.

2. Detyrat e pozicionit të punës

- Koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave të rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe ndërprerjes së e marrëdhënieve të punës.
- Koordinon dhe mbikëqyr procedurat lidhur me hartimin e përshkrimeve të punës në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive.
- Analizon dhe propozon strukturën dhe nivelin e pagave, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare e jofinanciare.

3. Kërkesat e pozicionit të punës

- Edukimi: Diplomë Master shkencor apo Master profesional në Shkenca shoqërore / ekonomike / juridike.
- Gjuhë e huaj : Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente)
- 7 vjet eksperiencë pune në burime njerëzore nga këto 3 vite eksperiencë në pozicion drejtues.

4. Dokumentacioni për dorëzim

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- Diplomë Bachelor dhe/ose master e noterizuar.
- Fotokopje e librezës së punës.
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të tjera

- a) Aftësi shumë të mira komunikuese
- b) Aftësi organizative
- c) Aftësi për të punuar në grup
- d) Aftësi drejtuese

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**

Kandidatët që marrin të paktën 60 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen te lista e pritjes

SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil do të shpallë fituesit në faqen e tij të internetit. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni në adresën zyrtare [rekrutime@caa.gov.al/](mailto:rekrutime@caa.gov.al)

Vetëm aplikantët të cilët kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në shpallje do të njoftohen për intervistë.